



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Vazhdim i afatit - Kërkesë për Shprehje të Interesit

Data: Tetor 08, 2024

Shteti: Kosovë

ID e projektit: P171098

Numri i ref: SAS.1.1.ICS.007

Emri i Kredive të Bankës Botërore: Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale në Kosovë

KUSHTET E REFERENCËS

**TRE ANALISTË PËR TË MBËSHTETUR PROCESIN E MONITORIMIT DHE
VLERËSIMIT SAS ME METODA SASIORE**

HISTORIKU

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) e Republikës së Kosovës po zbaton një projekt për pilotimin e reformës së asistencës sociale. Qëllimi i projektit është përmirësimi i barazisë dhe përshtatshmërisë së rrjetit të sigurisë sociale të Kosovës duke ndihmuar në zhvillimin e legjislacionit, krijimin e një regjistri social dhe mbështetjen e familjeve më të varfra në Kosovë. Përmirësimi i barazisë do të përfshijë përzgjedhjen e përfituesve të SAS bazuar në statusin e varfërisë (në vend të kategorive), ofrimin e përfitimeve më adekuate, duke përfshirë një rritje në përfitimin për frymë për familjet e mëdha, si dhe sigurimin që përfituesit e aftë për punë të përfitojnë nga masat e aktivizimit. Përmirësimi i përshtatshmërisë i referohet rritjes së kapacitetit të rrjetit të sigurisë sociale të Kosovës për t'iu përgjigjur ndryshimeve në nivelet e varfërisë në Kosovë, si dhe tronditjeve, përfshirë ato të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, për të minimizuar ndikimet negative në nivelin e varfërisë së familjeve.

Këto objektiva do të arrihen duke mbështetur Qeverinë për të (a) reformuar dizajnin e SAS-it dhe (b) bërë investime në sistemet e dorëzimit të SAS-it. Këto investime pritet të çojnë në një rrjet sigurie sociale që është më i aksesueshëm për familjet më të varfra, ofron përfitime më

domethënëse dhe mund të zgjerohen ose të tkurren në varësi të ndryshimeve në nivelet e varfërisë ose tronditjeve.

Qëllimi i Pilotit të Reformës SAS është të testojë një metodologji të re për përcaktimin e përfituesve të SAS-it (duke përdorur Testin e Mjeteve dhe Testin e Proxy-Mjeteve), si dhe dixhitalizimin e procesit të skemës SAS. Kjo ka për qëllim të mbështesë dhe lehtësojë qëllimin e përgjithshëm të MFPT për hartimin e ligjit të ri të SAS dhe zbatimin e Reformës SAS. Piloti SAS do të shtrihet në të gjithë vendin dhe do të synojë familjet më të varfra në Kosovë. Ndërkohë që çdo familje që banon në Kosovë, përfshirë përfituesit ekzistues të SAS-it, mund të aplikojë në Pilotin SAS, vetëm aplikantët më të varfër do të përzgjidhen për të përfituar nga Piloti dhe do të marrin përfitime mujore në para.

Si pjesë e reformës së asistencës sociale, do të krijohet një plan gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin e programit pilot SAS për të siguruar mbikëqyrje në kohë të tij. Ky plan do të mundësojë veprime korigjuese të shpejta dhe do të ofrojë njohuri të vlefshme për të udhëhequr reformën më të gjerë të SAS-it. Për të arritur këto qëllime, plani do të përdorë një qasje të përzier metodash, duke përfshirë të dhëna administrative dhe mbledhje të të dhënave sasiore.

Në këtë kontekst, MFPT kërkon të angazhojë tre analistë për të mbështetur vlerësimin e perceptimit dhe ndikimit të Pilotit SAS tek përfituesit e SAS-it. Analistët do të angazhohen në punë analitike dhe do të ndihmojnë në formësimin e politikave të mëtejshme që lidhen me mbrojtjen sociale.

OBJEKTIVI

Për të vlerësuar zbatimin e pilotit të SAS-it, MFPT kërkon të punësojë tre analistë dhe aktivitetet e tyre do të përqendrohen kryesisht në: (i) Analiza e perceptimit dhe përvojës së aplikantëve dhe përfituesve të pilotit SAS gjatë procesit të aplikimit (duke përfshirë të gjitha hapat në proces nga marrja e informacionit për pilotin, deri te procesi i aplikimit, regjistrimi, njohuria dhe përdorimi i mekanizmave të ankesave, etj.) (ii) Eksplorimi i ndikimit të masave të pilotit SAS në familjet e varfra dhe të cënueshme, 6 muaj pas pagesës së parë duke analizuar të dhënat e mbledhura nga anketa telefonike. (iii) Mbështetja e përpjekjeve për mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë dy anketa telefonike të ardhshme të synuara për aplikantët e pilotit SAS dhe përfituesit ekzistues të SAS-it. Mbështetja përfshin punën në përzgjedhje, testimin e instrumenteve të anketës, programimin e anketave në mënyrë që të dhënat të mblidhen në mënyrë elektronike. (iv) Mbështetja e analizës së burimeve të ndryshme të të dhënave, përfshirë të dhënat e anketave telefonike që do të mblidhen, si dhe të dhëna të tjera administrative. (v) Mbështetja e PCU për raportimin mbi treguesit e nevojshëm të Projektit të përshkruar në kornizën e rezultateve të Projektit. (vi) Ofrimi i mbështetjes së përgjithshme për Departamentin e Politikave Ekonomike në analizimin e aplikimeve të dorëzuara për asistencë sociale, si dhe programe të tjera të lidhura me mbrojtjen sociale.

FUSHËVEPRIMI

Analistët e përzgjedhur, përmes analizës së detajuar, do të: (i) Kryejnë analiza dhe përgatisin statistika përshkruese të të dhënave të aplikimeve dhe përfituesve (përfituesit aktualë dhe të rinj të SAS-it dhe ata që nuk janë të përfshirë në Pilot); (ii) Eksplorojnë ndikimin e masave të pilotit SAS në jetesën dhe mirëqenien e qytetarëve të varfër dhe të cenueshëm; (iii) Ndhmojnë në rishikimin e aplikimeve, kryerjen e testeve të nevojshme, mirëmbajtjen e bazave të të dhënave, lidhjet ndërinstitucionale të bazave të të dhënave; (iv) Ndhmojnë ekipin përgjegjës me analiza të tjera të ad-hoc; (v) Ndhmojnë Departamentin e Politikave Ekonomike në detyra të tjera përkatëse.

Analistët e përzgjedhur do të sigurojnë përgatitjen e dorëzimeve të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në sa vijon:

1.1 Një afat kohor i ngjarjeve kryesore dhe dorëzimeve kryesore.

1.2 Raporte për instrumentet e anketës: Raport feedback-u nga një pilot i shkurtër për secilën nga dy anketat e të paktën 10 familjeve, i paraqitur në një dokument të përmbledhur me metodologjinë, gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e pyetësorit.

1.3 Fletë gjurmimi me numrin e thirrjeve të bëra para se të kontaktoheshin të anketuarit dhe shënime nëse intervistat nuk janë përfunduar ose nëse i anketuari nuk është arritur.

1.4 Baza të dhënash të papërpunuara në STATA, Excel ose ASCII të siguruar menjëherë pas çdo ankete.

1. Përshkrimi dhe peshat e përzgjedhjes duke siguruar një mostër përfaqësuese të aplikantëve të pilotit SAS, si dhe atyre të përzgjedhur dhe jo të përzgjedhur në program. Mostra gjithashtu do të synojë të maksimizojë aftësinë për të matur ndikimet nga programi (fuqi e lartë statistikore) bazuar në një qasje të dallimit-në-dallim (krahasimi i rezultateve para dhe pas ndërhyrjes midis atyre të përzgjedhur dhe jo të përzgjedhur në Programin Pilot SAS).
2. Përgatitja e një raporti që përmban: 3.1 një përshkrim të shkurtër të punës së kryer, dorëzimet dhe çdo informacion tjetër të lidhur me organizimin dhe ekzekutimin e përgjithshëm të anketës, futjen e të dhënave dhe organizimin e skedarëve të prodhimit, duke theksuar çdo vështirësi, sfidë dhe devijim të dukshëm nga plani fillestar.

KOHËZGJATJA DHE PAGESA

Kontrata pritët të fillojë në shtator 2024 dhe të zgjasë deri në tetor 2025. Analistët do të punojnë me orar të plotë dhe do të paguhën në baza mujore me një pagë prej 1,250 eurosh (paga bruto, duke përfshirë të gjitha kontributet pensionale dhe tatimet). Të gjitha të dhënat dhe informacionet e mbledhura ose të marra për qëllime të anketës telefonike dhe të gjithë projektit SAS do të mbahen reptësisht konfidenciale dhe do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e KTP-së. Baza e të dhënave të përfunduar do të jetë pronë e Qeverisë së Kosovës, me të drejta përdorimi dhe qasje nga Grupi i Bankës Botërore.

KUALIFIKIMET E ANALISTËVE

- Diplome Master/Specializimi në Shkenca Sociale, Ekonomi, Financë, Statistika, Matematikë Financiare, Menaxhim, Administrim Biznesi, Administratë Publike ose në një fushë tjetër të ngjashme:
- Analistët duhet të kenë minimumi 3 vjet përvojë të dëshmuar në kryerjen e kërkimeve dhe analizave gjithëpërfshirëse, përfshirë përvojën e dëshmuar në kryerjen e kërkimeve gjithëpërfshirëse në Kosovë me analiza të të dhënave të anketave kuantitative.
- Analisti duhet të njeh shume mire financat publike dhe temat makroekonomike, me përvojë praktike në analizimin dhe interpretimin e të dhënave ekonomike, kryerjen e analizave të politikave ekonomike dhe raportimin mbi çështjet ekonomike.
- Analistët duhet të kenë përvojë të dëshmuar me vlerësime të kryera mbi mirëqenien e familjeve, sektorin social dhe varfërinë në Kosovë.
- Preferohet që analistët të kenë përvojë të dëshmuar me vlerësime të kryera përmes CATI ose programeve të tjera për mbledhjen e të dhënave.
- Analistët duhet të kenë njohuri të forta në Python ose STATA dhe aftësi të avancuara në Excel, të demonstruara përmes përvojës praktike në analizimin dhe raportimin e të dhënave.
- Dëshirohet që analistët të kenë përvojë në kryerjen e anketave kuantitative në nivel familjar ose individual në gjuhët shqipe dhe serbe.
- Dëshirohet që ata të kenë përvojë të dëshmuar në mbledhjen e të dhënave në nivel familjar, përfshirë menaxhimin e anketuesve.
- Përvoja në punën me organizata ndërkombëtare dhe agjenci donatore do të jetë një avantazh.

MARRËDHËNIET DHE DETYRIMET E RAPORTIMIT

Konsulentët do t'i raportojnë menaxherit të kontratës të caktuar nga Zyra e Sekretarit, Koordinatorit të Projektit dhe Drejtorit të DSS, si dhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm.

Kriteret e vlerësimit janë:

Përshkrimi	Pikët
Kualifikimet e përgjithshme	40 pikë
Përvoja në detyrë të ngjashme	60 pikë
	100 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar i referohet Seksionit VII, paragrafëve 7.34, 7.35, 7.36 dhe 7.37 të "Rregulloreve të Prokurimit për Huamarrësit e IPF-së" të Bankës Botërore, Korrik 2016 ("Rregulloret e Prokurimit"), që përcakton politikën e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e Konsulentit Individual (IC) në marrëveshjet e mësipërme të Marrëveshjes Kuadër të përshtuara në Rregulloret e Prokurimit dhe duke ndjekur kriteret e përmendura më lart për vlerësim.

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën më poshtë gjatë orarit zyrtar, përkatësisht nga ora 08:00 deri në 16:00.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në version elektronik në adresën më poshtë (me e-mail) deri me 15 Tetor 2024, deri në orën 16:00, dhe duhet të përfshijnë:

- CV
- Dëshmi të kualifikimeve (diploma dhe certifikata)
- Dëshmi të përvojës së punës (referencë, kontratë ose deklaratë besimi)

Projekti për Reformën e Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë (SAS)

Njësia e Koordinimit të Projektit – PCU

Sheshi “Edit Durham” nr.46, Prishtinë

Ndertesa e ish Kino Armata,

Kati 1, zyra numer 107, 10 000 Pristina, Kosovo

E-mail: procurement.SAS@rks-gov.net